



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BULQIZE**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Bulqize, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** “Sistemim asfaltim i rruges lagje Ruse-Jelle, fshati Homezh, Njesia Adm Shupenze.”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45000000 - 7, Pune ndërtimi.**

**Vlera e fondit limit:** 19 919 068.18 (Nentemdhjete milion e nentëqind e nentemdhjete mije e gjashtedhjetë e tete pike tetemdhjete ) Leke pa tvsh.  
e ndare perkatesisht ne dy vite per vitin 2024 me nje vlere prej 8 000 000( tete milion) leke pa tvsh dhe per vitin 2025 ne nje vlere prej 11 919 068.18 ( njemdhjete milion e nentëqind e nentemdhjete mije e gjashtedhjetë e tete pike tetemdhjete )Leke pa tvsh.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Bulqize**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a.** *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**b.** *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç”

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022, 2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 /b e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare**;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.**

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:  
**b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021**, **2022**, dhe **2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit<sup>1</sup>, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 2.2.1 dhe pika 2.2.2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kane detyrime te prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020

“Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar),

---

<sup>1</sup>

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

**Ose**

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontrata te ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Ne rastin kur operatoret ekonomike, anetar te nje bashkimi, kane te njejten perqindje pjesemarrje ne bashkim, vendosin me marreveshje ne kontraten e bahkepunimi se cili prej tyre do te permbushet kete kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet te pltesohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.*

**2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:**

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- IV. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- V. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimtar të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- IV. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- V. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikavate siperpermendura , të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e*

*teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

AK ka kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **NP-1 A** (Punime gërmimi në tokë)
- **NP- 4A** (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)
- **NP- 7A** ( Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje)
- **NS-1A** ( Punime per prishjen e ndertimeve)
- **NS-6A** ( Sinjalistke rrugore jo ndriçuese)
- **NS-18 A** (Punime topogjeodezike)

*\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

**\* Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licences sipas marreveshjes.**

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.*

**AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.**

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

#### **N.P-1A** (Punime gjurmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmimi në tokë ( **konkretisht zerrat me numer analize: 3.104/b , 3.89/a etj**) ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

#### **NP- 4A** (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndertimin e infrastruktures rrugore ( **konkretisht zerrat me numer analize 3.229/1, 3.224/1, 3.212/b etj**) është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.P-4 ku bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

#### **NP- 7A** ( Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje)

Ne preventivin e punimeve të këtij objekti janë parashikuar edhe punime për ndertimin e veprave të artit + kanalizime , si psh kalime me tuba nën rrugë( tip tombino) , struktura betoni për kanale anësore etj.

#### – **NS-1A** ( Punime për prishjen e ndertimeve)

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me prishjen e strukturave të betonit ( **konkretisht zerrat me numer analize: 3.405, 3.405/1, 3.2 dhe 3.3**) të cilat shtojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për këto kategori.

#### – **NS-6A** ( Sinjalistike rrugore jo ndriçuese)

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me sinjalistika në rrugë (**konkretisht zerrat me numer analize: 3.955, 3.301, 3.943/1 etj**), të cilat shtojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-6.

#### – **NS-18 A** (Punime topogjeodezike)

Duke qenë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, vecanerisht (**proceset e punës për gjurmim përmbushje të rrugës, shtresat asfaltike, punimet e betonit etj, sipas preventivit**)dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

### **2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- a.** Çertifikatën mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).
- b.** Çertifikatën mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ISO 45001-2018, (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë



Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).

- c. Çertifikatën mbi sistemin e menaxhimit të trafikur rrugor ISO 39001:2012, (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, secili operator ekonomik duhet të paraqesë çertifikata ISO sipas zerave të punimeve që do të mar persiper të realizoj sipas **marreveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve.***

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.4 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë**, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia.** AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 sipas zerave të punimeve të marra persiper, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS).** AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda

në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (*Sistemi asfaltim rruge*)

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **25 (njetete e pese) punonjës** për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe drejtuesit teknik, stafi mbeshtetes, specialistet dhe punetoret per realizimin ekesaj kontrate.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për pikat 1 dhe 2.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. ç) **fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Raportit/Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **25 (njetete e pese)** punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj duke iu referuar **dhe perlllogaritjes teknike te kryer nga specialisti i fushes** bashkangjitur tabela e perlllogaritjes per makineri,punetori, sipas analizave teknike te manualit per cdo ze punimesh.Numri i vendosur per punonjesit i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

**2.3.6.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te përfshirë në licencën e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Gjeodet/topograf/markshajder 1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)

*Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave duhet të dorëzojë dokumentacionin provues.*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. *“një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...*

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës kapacitetit teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. **Referuar preventivit të Punimeve** si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP 1 , NP 4 , NS 1 dhe NS 6 është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi. Ku është kërkuar NS 18, është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri. Per punimet e preventivit që lidhen me piken e licences NP 7 nevojitet inxhinieri hidroteknik.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjes të specializuar/ të kualifikuar dhe të figuroj një listpagesat e shoqërisë per 3 muajt të fundit. Si me poshte:

- a) OE ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 ( **dy**) **punonjes manovrator** , per të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, deshmia aftësie profesionale( të vlefshme), leshuar nga institucionet përkatëse, deshmia të sigurimit Teknik ( të vlefshme) dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë tre muajt e fundit

- b) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 ( **dy**) **punonjes shofer** per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune, deshmia aftesie profesionale( te vleshme), leshuar nga institucionet perkatese dhe te figuroje ne listapgesa te shoqerise tre muajt e fundit
- Shenim: (Ne rastin kur punonjesit manovrator/shofer jane te kontraktuar me kontrate pune ( respektivisht per mjetet e marra me qera) nuk kerkoet te figurojne ne listapgesen e shoqerise)**
- c) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 ( nje) **Teknik ndertimi** , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale( te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit Teknik ( te vlefshme) dhe te figuroje ne listapgesa te shoqerise tre muajt e fundit
- d) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 ( nje) **Hidraulik**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale( te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit Teknik ( te vlefshme) dhe te figuroje ne listapgesa te shoqerise tre muajt e fundit
- e) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 ( nje) **Betonues** , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit Teknik ( te vlefshme) dhe te figuroje ne listapgesa te shoqerise tre muajt e fundit .
- f) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 ( nje) **karpentier** , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit Teknik ( te vlefshme) dhe te figuroje ne listapgesa te shoqerise tre muajt e fundit

Kriteri per piken 2.3.7 konsiderohet I permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 8 te DST-se. Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkise Bulqize dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në

konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit Teknik të punësuar staf Teknik (specialist, punetor) për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt,është kerkuar kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse/*çertifikatë e arsimit profesional*) sipas ligjitNr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te ket ne stafin e tij personel te kualifikuar/certifikuar si:

- a. Nje (1) punonjes “pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune ”, I cili duhet te jete I certifikuar “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune ” ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18.02.2010 “ Per sigurine dhe mbrojtjen ne pune” dhe VKM NR 312 date 05.05.2010, “Per Miratimin e Rregullores per Sigurine ne Kantjer.”

*Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave duhet te dorezoje dokumentacionin provues.*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, ***punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë.*** Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

**2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e konkretisht:**

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

<b>Nr</b>	<b>LLOJI I MAKINERIVE</b>	<b>PRONESIA</b>	<b>SASIA Minimumi</b>
•	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Kamionçine kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Fadrome me gome	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autovinc	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Rrul ngjeshes me vibrim per nenshtresat	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Linje asfalto betoni e pajisur me leje mjedisore	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	1 cope
•	Linje inerte e pajisur me leje mjedisore	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	1 cope
•	Armature	Ne pronesi ose me qira	150 m2
•	Autobitumatriçe	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Asfalto shtruese	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Vibrator betoni ose thellesi	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Rrul ngjeshes me kompresor per shtresat asfaltike	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	1 Cope
•	Makineri vijeziimi	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	1 cope

•	Autobot uji ose depozite uji	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Minieskavator	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1cope

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për punetoret e mesiperm.*

- a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit.
- b) Per mjetet e siguruar me qera,dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leja e qarkullimit)plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit si dhe duhet te shoqerohen me kontraten perkatese noteriale te qerese ,evlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) **Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave(te vlefshme),leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik
- e) **Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera,(Deklarate nga Administratori I Shoqerise Ofertuese).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, ***Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.***

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, nga ana e specialistit te fushes eshte precaktuar duke marre ne konsiderate zerat e preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë tipologjinë dhe natyrën e punimeve. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

*Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:*

*“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**